



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 10 .10.2016, në ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Xhevahire Izmaqi, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Zenun Pajaziti, Agim Kikaj, Lahi Brahimaj dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Shqipe Pantina dhe Jelena Bontiq.

Në mbledhje morën pjesë: Edita Tahiri, Minsitre për Dialog , përfaqësuesit e Zyrës së KE dhe KDI-së.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Xhevahire Izmaqi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 26.09.2016;**
- 3. Raportimi i Ministres për Dialog, znj. Edita Tahiri;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 26.09.2016;

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i Ministres për Dialog, znj. Edita Tahiri;

Xhevahire Izmaku, filloi mbledhjen duke e njoftuar ministren, znj. Edita Tahiri, se qëllimi i ftesës është që të njoftohet komisioni lidhur me atë se asociacioni i komunave me shumicë serbe a ka kompetenca ekzekutive, a është shkel Kushtetuta e Kosovës me marrëveshjen e Brukselit për asociacionin e komunave me shumicë serbe.

Edita Tahiri, tha se marrëveshja e Brukselit për parimet themelore për krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, të dt. 25 gusht 2015, është në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet në fuqi. Zbatimi i marrëveshjes, përkatësisht statuti i asociacionit do të respektojë Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të dt. 26 dhjetor 2015, asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do të jetë nivel i tretë i qeverisë.

Asociacioni do të jetë një strukturë e përbërë nga komunat serbe që operon në pajtim të plotë me ligjet në fuqi dhe kushtetutën dhe që do ti ndihmojë komunave në realizimin e çështjeve lokale.

Asociacioni nuk mund të merr vendime për komunat dhe në emër të komunave si anëtare të saj, sepse komunat kanë kompetenca ekzekutive të cilat nuk mund të barten tek asociacioni.

Asociacioni është në pajtim me ligjet, kushtetutën dhe kartën evropiane për pushtetin lokal, origjina për idenë e formimit të asociacionit e ka burimin nga Plani i Ahtisarit, i cili plan është bazë për hartimin e Kushtetutës së Kosovës. Sipas dokumentit të parimeve, asociacioni do të kontribuojë në integrimin e serbëve të Kosovës në sistemin ligjor dhe kushtetues, mbi bazë të cilit sistem do të shuhen strukturat paralele të serbëve që si kusht themelor për themelimin e asociacionit është shuarja e tyre, domethënë, pa shuarjen e strukturave paralele nuk mund të ketë asociacion.

Në raport me institucionet qendrore, asociacioni mbron dhe promovon interesat e komunitetit serb, mbrojtja e të cilave interesa është synim i institucioneve të Kosovës.

Obligimet dhe përgjegjësit e asociacionit janë të kufizuara me vështirime të përgjithshme për çështjet lokale, jashtë mundësisë për të marrë autorizime për menaxhim apo të ndikojnë në funksionimin normal të autoriteteve publike të nivelit qendror apo lokal.

Anëtarësimi i komunave në asociacion bëhet në baza vullnetare, njësoj edhe dalja prej asociacionit bëhet në baza vullnetare, siç është e promovuar me kartën evropiane për qeverisje lokale.

Asociacioni nuk mund të bëhet pronë e pasurisë publike e nivelit lokal apo qendror dhe nuk ka rol në asetet e Kosovës.

Zafir Berisha, tha se, përveç prezantimit për asociacionin është pritur një raport më i gjerë lidhur me atë që po ndodh në Bruksel, sepse jo vetëm qytetarët, por edhe deputetët nuk janë të njoftuar për bisedimet dhe kjo kërkohet në emër të transparencës.

Fillimisht, ajo që është edhe publike se bisedimet janë gabim i Kosovës në raport me Serbinë, të cilat bisedime janë cilësuar si teknike sipas Qeverisë, dhe ato tani janë edhe më shumë se politike, kulmi i të cilave ka qenë marrëveshja e 19 prillit të vitit 2013, nga e cila rrjedhin të gjitha dëmet për Kosovën në raport me Serbinë, përfshirë edhe asociacionin. Për fillimin e bisedimeve, Kosova është dashur me parashtruar kushte, sepse Kosova ende ka më se 1600 persona të zhdukur.

Duke ju drejtuar ministres, ai tha se, keni hy në bisedime me një shtet që ende në kushtetutën e vet e ka Kosovën si territor të vet dhe keni filluar bisedimet duke ju trajtuar si përfaqësues të një province duke i tejkaluar përgjegjësitë në mbrojtjen e kushtetutshmërisë së Kosovës.

Nuk qëndron që asociacioni është në pajtim me kushtetutën, Kosova ka një asociacion të komunave, pse është dashur të bisedohet edhe për krijimin e një asociacioni tjetër, më e keqja është që Serbia është bërë palë e bisedimeve për çështje të brendshme të Kosovës.

Sadri Ferati, jemi në prag të formimit të asociacionit dhe ende nuk e dimë a është asociacioni OJQ apo bartje e kompetencave të Serbisë në Kosovë, pasi që sipas marrëveshjes asociacioni nuk rregullohet me ligj, por me statut.

Ai pyeti, se a është biseduar për kufijtë administrativ të komunave, konfirmimin e vijës kufitare, si dhe kërkoi që komisioni të informohet kohe pas kohe për përpilimin e statutit të asociacionit.

Agim Kikaj, propozoi aniliguitetin e të shprehurit e të gjitha marrëveshjeve me qëllim të shmangies së keqkuptimeve, por edhe harmonizimin e teksteve në të tri gjuhët.

Kujtim Paçaku, pas përfundimit të takimeve të Brukselit, për të njëjtën çështje ka pasur informata të dykuptimta dhe kontradiktore, lidhur me këtë pyeti se cila ka qenë e vërteta nga informacionet e dyanshme.

Zenun Pajaziti, lidhur me bisedimet për çështjen e asociacionit, tha se, opinionin ka qenë i njoftuar njëanshëm, kërkesa e tij për ministren ishte që ajo të jetë në Kuvend në emër të transparencës për deputetët, jo vetëm çështjen në fjalë, por edhe për të gjitha çështjet tjera rreth zbatimit të marrëveshjeve apo edhe moszbatimit të tyre.

Në fund të mbledhjes znj. Tahiri propozoi që për çdo pyetje shtesë, po qe se kanë deputetët mund të drejtohen në adresën zyrtare për përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Xhevahire Izmaku